

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ 9 Mountain ” SH.P.K

Sot më datë 22 /02 /2025 (dymije e njezete e pese) u paraqitën personalisht shtetasit e mëposhtëm:

1. **Z. Ardit Ademi**, atësia Astrit, amësia Mimoza, shtetas Shqiptar, lindur në Peshkopi, Diber dhe banues në Dibër, me adresë Lagja " Gjok Doçi"; Nd. 071; Peshkopi; Peshkopi; 8301; Dibër, lindur më 20/04/1990, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033251113 dhe nr. personal J00420006I.

I cili me cilesine e themeluesit me kerkoj redaktimin e ketij akt themelimi, nepermjet te cilit ai deklaroi se me vullnet të lire e të plote dhe iniciativen e lire private, mbështetur ne Kushtetuten e Republikës se Shqipërisë dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “ Per Tregtarët dhe shoqëritë tregtare “, ne ligjin Nr. 9723 date 03.05.2007 “ Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, ne Ligjin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojne shoqërine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, **“ 9 Mountain ” sh.p.k.**

KREU 1

Neni 1
Krijimi

Shoqëria , **“ 9 Mountain ”sh.p.k.**, është person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqëri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqëria”).

Neni 2
Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit (QKB), në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria **“ 9 Mountain ” sh.p.k.**, është një shoqëri, kapitali i së cilës ndahet në PJESE dhe që themelohet ndërmjet ortakëve që përballojnë humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 3
Selia

Selia e Shoqërisë është ne Tirane ,Rr.Muhamet Gjollësja , Nr. Pasurie 2/527/ND+1-10 ZK.8250,Vol.28 ,Fq.66 .Shoqëria mund te ndryshoje seline e saj, te hape edhe zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikës se Shqipërisë, vetëm me vendim te Asamblese se Pergjithshme.

Neni 4
Objekti i veprimtarisë :

Objekti i veprimtarisë te kesaj shoqërie është: Ndertim te objekteve te ndryshme industriale, socialkulturore, te infrastruktures, ndertim te apartamenteve dhe te vilave te banimit, te kanalizimeve dhe te ujesjellsave, prodhime te materialeve te ndertimit, rehabilitim dhe rikonstrukcion te ndertimeve civile



dhe jo civile, import eksport te materialeve ndertimore dhe gjithë produkteve ne funksion te aktivitetit. Kryerja e çdo lloj aktiviteti me qellim realizimin e aktivitetit me qellim realizimin e aktivitetit kryesor duke pasur te drejten e shtimit ose te pakesimit te objektit te asamblese se pergjithshme te ortakeve themelues. Dhenie me Qera ambjenti ndertimi, apartamente, lokale sherbime etj

NENI 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje afat te pacaktuar.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise “**9 Mountain**” sh.p.k.

Kapitali themelues i shoqerise 100 000 (njeqind mije), i shprehur ne 1 kuota me vlere 1 kuote 100,000 leke, i kontribuar nga ortaku,

Ardit Ademi 1 kuote me vlere 100 000 Leke(njeqinde mije).

Me vendim te Asamblese se ortakeve kapitali mund te rritet sipas formave te parashikuara nga ligji.

Ortaket pergjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve, deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 7

TRANSFERIMI KAPITALIT

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te tij ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Pjesët e kapitalit themeltar janë të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8 Organi Vendimmarres

Asambleja e ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e ortakeve eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Asambleja e ortakeve, vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veproj si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9 Ndryshimet e Statutit

Ndryshimet e statutit vendosen nga ortakët që përfaqësojnë të paktën tre të katërtat e pjesëve të kapitalit themeltar. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane Qendres Kombetare te Regjistrimit per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 10 Administrimi

Administrimi i shoqerise do te behet nga 1 administrator:

1.Administrator i shoqerise emerohet: **Z.Ardit Ademi**, atësia Astrit, amësia Mimoza, shtetas Shqiptar, lindur në Peshkopi, Diber dhe banues në Dibër, me adresë Lagja " Gjok Doçi"; Nd. 071; Peshkopi; Peshkopi; 8301; Dibër, lindur më 20/04/1990, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033251113 dhe nr. personal J00420006I .

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorët në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.



Neni 11

Kompetencat

Administratores kane të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ua jep shprehimisht ortakëve.

Administratores angazhojne shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorëve e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e këtij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Administratorit ose ortakëve që nuk janë persona juridikë nuk u lejohet të kontraktojnë në çfarëdolloj forme qoftë, të marrin hua te shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzënës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Neni 12

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 13

SHPERNDARJA SHOQËRISE

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak, edhe para plotësimit të afatit për të cilin është krijuar sic mund të jenë :

- a) Humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhdimit të metejshëm të veprimtarisë së saj.
- b) Në një nga menyrat e parashikuara nga ligji “ Për Falimentimin e Shoqërive Tregtare”
- c) Kur plotësohet afati i caktuar për ushtrimin e veprimtarisë tregtare.

Në këto rast Asambleja e Ortakëve merr vendim me shkrim në të cilin parashikon menyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtesë “ Shoqëri në likuidim e sipër “.

Neni 14

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi, statutin dhe dispozitat e legjislationit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.



Neni 15
Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 16
Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 kopje me permbajtje dhe vlere te njejte juridike, ne gjuhen shqipe, dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket themelues te shoqerise tregtare “9 Mountain” sh.p.k. nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tyre orgjinale.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE “9 Mountain” sh.p.k

Z. ARDIT ADEMI

Ardit Ademi 